3. Znj. Besa Ombashi të emërohet anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.303, datë 31.3.2011

**PËR KRIJIMIN E NJËSIVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
E TË KOMUNIKIMIT NË MINISTRITË E LINJËS DHE INSTITUCIONET E VARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 2 të nenit 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), si strukturë organizativo-teknike për projektimin, zbatimin dhe administrimin e qeverisjes elektronike, nëpërmjet teknologjisë së informacionit e të komunikimit (TIK), si struktura të veçanta në ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë.

2. Njësia e teknologjisë së informacionit e të komunikimit është përgjegjëse për:

a) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e reformave, programeve dhe projekteve në ministri dhe në institucionet e varësisë, me qëllim hartimin, zbatimin, promovimin dhe ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe nismave të TIK-së;

b) administrimin e infrastrukturës, sistemeve dhe shërbimeve të TIK-së në ministritë e linjës dhe në institucionet e varësisë;

c) bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërinstitutional, me qëllim promovimin dhe zbatimin e nismave të TIK-së dhe sigurimin e lidhjes e të koordinimit me Ministrin për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, si dhe me ministritë e tjera të linjës, për zhvillimet në qeverisjen elektronike dhe në fushën e shoqërisë së informacionit në përgjithësi;

ç) hartimin e planeve të zhvillimit dhe të përparësive respektive për shërbimet *on line* në ministri e në institucionet e varësisë;

d) evidentimin dhe planifikimin e kërkesave për burime njerëzore dhe financiare, të nevojshme për zhvillimin e shërbimeve *on line* në ministri dhe institucionet e varësisë;

dh) raportimin dhe ndërveprimin me këshillin teknik për qeverisjen elektronike (e-Gov) dhe TIK-në, për politikën për zhvillimin e TIK-së të institucioneve përkatëse e, veçanërisht, sigurimin e ndërveprimit me bazat e të dhënave;

e) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punëve me strukturat e tjera të ministrisë e të institucioneve të varësisë, me qëllim informimin e publikut për të gjitha shërbimet e ofruara nga ministria dhe nga institucionet e varësisë, si dhe koordinimin e punës në nivel të përgjithshëm mes NJTIK-ve të ministrisë dhe NJTIK-ve të institucioneve të varësisë, duke qenë pjesë e vendimmarrjeve të rëndësishme të ministrisë;

ë) planifikimin dhe zbatimin e politikës e të programeve të përgjithshme dhe/ose të veçanta të trajnimit, që aplikohen në ministri e në institucionet e varësisë, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e TIK-së.

3. Pranë Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit funksionon Këshilli Teknik për Qeverisjen Elektronike (e-Gov), i kryesuar nga zëvendësministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, me nënkryetar, drejtorin e përgjithshëm të AKSHI-t dhe me anëtarë të përhershëm:

a) 1 (një) përfaqësues të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit;

b) zëvendësdrejtorin e përgjithshëm të AKSHI-t dhe drejtorët e drejtorive të përmbajtjes të AKSHI-t;

c) drejtorin e Departamentit Shqipëria Digjitale (DEDAL);

ç) drejtuesit e njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit të ministrive të linjës e të institucioneve të varësisë.

4. Këshilli Teknik për Qeverisjen Elektronike (e-Gov) ka këto përgjegjësi specifike:

a) mbledh, përpunon dhe analizon informacionin për zhvillimin e shërbimeve e-Gov në ministrinë e linjës e në institucionet e varësisë dhe, bazuar në gjendjen aktuale, diskuton dhe propozon pranë Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe ministrit të linjës, projektakte normative, për çështjet që kanë lidhje me politikat kryesore në fushën e shoqërisë së informacionit;

b) siguron përkrahjen dhe mbështet masat e marra nga institucionet për zbatimin e strategjisë së shoqërisë së informacionit;

c) bashkërendon punën për implementimin e projekteve për ngritjen e shërbimeve *on line* të administratës publike;

ç) maksimizon përdorimin e aplikacioneve, proceseve, produkteve, shërbimeve dhe infrastrukturave të TIK-së, të njëjta e të përbashkëta, me qëllim rritjen e shkallës integruese, menaxhim më të mirë dhe kosto më të ulët.

5. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Teknik për qeverisjen elektronike (e-Gov) përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit.

6. Ministrinë e linjës, institucionet e varësisë dhe Departamenti i Administratës Publike, për përcaktimin e pozicioneve, detyrave funksionale, si dhe të kriterëve të veçanta të nëpunësve të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit, marrin paraprakisht edhe mendimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit.

7. Ngarkohen ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë që të realizojnë analizën dhe kryerjen e rregullimeve në strukturat organizative përkatëse, si dhe të udhëzojnë, sipas rastit, për rregullat e bashkëpunimit ndërmjet NJTIK-ve të ministrisë dhe NJTIK-ve të institucioneve të varësisë, duke marrë edhe mendimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit.

8. Nëpunësit e strukturave ekzistuese të TIK-së, në administratën publike, të jenë pjesë e strukturës së re të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit.

9. Standardet e përgjithshme, minimale, për strukturimin organizativ dhe për përcaktimin e kriterëve të përgjithshme të nëpunësve të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit dhe mënyra e bashkëpunimit dhe e bashkërendimit të punës në këto njësi përcaktohen në rregulloren e NJTIK-ve, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i parashikuar për ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë.

11. Ngarkohen Kryeministria, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Integritit, si dhe institucionet e varësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.304, datë 6.4.2011

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR SHPËRBLIMIN E
LOJTARËVE DHE TË TRAJNERIT TË EKIPIT KOMBËTAR TË FUTBOLLIT, PËR
REZULTATIN E ARRITUR DHE NIVELIN E LARTË SPORTIV TË TREGUAR NË
NDESHJEN KUALIFIKUESE TË KAMPIONATIT EUROPIAN 2012,
SHQIPËRI-BJELLORUSI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në programin “Zhvillimi i sportit”, t’i shtohet kundërvlefata në lekë e fondit prej 225 000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) eurosh, për shpërblimin e lojtarëve të ekipit kombëtar dhe të trajnerit të tij, z.Josip Kuze, për rezultatin e arritur dhe nivelin e lartë sportiv të treguar në ndeshjen kualifikuese të Kampionatit European 2012, Shqipëri-Bjellorusi, zhvilluar në datën 26 mars 2011, sipas preventivit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PREVENTIV

**LISTA E PLOTË E LOJTARËVE TË EKIPIT KOMBËTAR SHQIPTAR TË FUTBOLLIT PËR
NDESHJEN KUALIFIKUESE TË KAMPIONATIT EUROPIAN 2012, SHQIPËRI-BJELLORUSI**

Lojtarët e Ekipit Kombëtar

1	Arjan Beqaj	10 000 euro
2	Saimir Ujkani	10 000 euro
3	Andi Lila	10 000 euro
4	Elvin Beqiri	10 000 euro
5	Kristi Vangjeli	10 000 euro
6	Anisi Agolli	10 000 euro
7	Admir Teli	10 000 euro
8	Lorik Cana	15 000 euro
9	Endrit Vrapit	10 000 euro
10	Ervin Bulku	10 000 euro
11	Altin Lala	10 000 euro
12	Klodian Duro	10 000 euro
13	Gilman Lika	10 000 euro
14	Emilian Vila	10 000 euro
15	Ervin Skela	10 000 euro
16	Jahmir Hyka	10 000 euro

17	Gjergj Muzaka	10 000 euro
18	Erjon Bogdani	10 000 euro
19	Hamdi Salihi	15 000 euro
20	Elis Bakaj	10 000 euro

Trajneri i Ekipit Kombëtar

Z.Josip Kuze

15 000 euro

URDHËR
Nr.49, datë 19.4.2011

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË MARRËVESHJES PËR
KRYERJEN E Oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 të ligjit nr.8402, datë 18.7.2002 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, si dhe pikës 2, 4 të vendimit nr.1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”,

URDHËROJ:

1. Oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit të kryhet nga Instituti i Ndërtimit dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit për:

- a) objekte banimi, social-kulturore e industriale;
- b) objekte hidroteknike e portuale (diga, tunele, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje, thellime në det);
- c) objekte të infrastrukturës së transportit (rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale).

2. Subjektet e mësipërme para kryerjes së oponencës teknike, lidhin një marrëveshje me porositësin, sipas marrëveshjes tip bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Pagesa për oponencën teknike të projekteve të bëhet sipas pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

4. Urdhri nr.187, datë 20.6.2004 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të aktmarrëveshjes dhe objektit të oponencave teknike të projekteve të ndërtimit, si dhe caktimi i institucioneve shtetërore për kryerjen e tyre shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MARRËVESHJE TIP

E mbajtur sot në Tiranë datë _____, midis:

Porositësi: _____

Sipërmarrësi: _____

Të cilët, me qëllim krijimin e marrëdhënies juridike, bazuar në kreun VII, neni 850 e në vijim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhin këtë marrëveshje me përmbajtje që vijon:

Objekti i marrëveshjes: _____

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet në momentin kur porositësi vë në dispozicion të sipërmarrësit të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tij.

2. Sipërmarrësi në rast se nuk realizon oponencën brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të kësaj marrëveshje, i paguan porositësit 0.01 % (për qind) të vlerës totale të projektit, për çdo ditë vonese.

3. Vlefta: Vlefta për realizimin e objektit sipas kësaj marrëveshje është _____ lekë, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin nr.1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

4. Afati: Dorëzimi i oponencës teknike pranë sipërmarrësit do të jetë _____ ditë/muaj nga data e lidhjes së kësaj marrëveshjeje.

5. Në rast se gjatë realizimit të objektit lindin mosmarrëveshje, palët i zgjidhin ato me mirëkuptim midis tyre, në rast të kundërt i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë për zgjidhje.

6. Paga e vleftës për realizimin e oponencës kryhet në momentin e dorëzimit të saj te sipërmarrësi në nr. e llogarisë _____ dhe IBAN _____.

Klienti brenda afatit dhe kushteve të marrëveshjes, duhet të realizojë oponencën teknike për projektin e veprës së ndërtimit _____.

7. Kjo marrëveshje hartohet në 3 kopje origjinale, me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve.

Porositësi

Znj./Z. _____

Sipërmarrësi

Znj./Z. _____

Shënim. *Sipërmarrësi do të jetë njëri nga subjektet e përcaktuara në urdhrin bashkëlidhur.

VENDIM

Nr.36, datë 15.4.2011

MBI ANKIMIMIN E “CEZ SHPËRNDARJE” SHA TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.31, DATË 31.3.2011 “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 1.1.2011 – 31.12.2011”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi ankimimin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në lidhje me kontratën e furnizimit me energji për vitin 2011 ndërmjet KESH sh.a. dhe CEZ Shpërndarje” sh.a., dhe relacionin e drejtorive teknike,

Konstatoi se:

“CEZ Shpërndarje” sh.a., me anë të këtij ankimimi, ka paraqitur në ERE të njëjtat argumente që janë diskutuar me palët për këtë çështje gjatë komunikimeve zyrtare në adresë të njëra-tjetrës, si dhe në ERE, sikurse edhe gjatë mbledhjeve të Bordit të Komisionerëve të datave

4.3.2011 dhe 31.3.2011, në të cilën përfaqësues të “CEZ shpërndarje” kanë qenë prezent. Ky ankimim nuk sjell asgjë të re dhe të panjohur nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos pranojë ankimimin e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe lënien në fuqi të vendimit nr.31, datë 31.3.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. (furnizuesi publik me pakicë) për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë ankimuese “CEZ Shpërndarje” sh.a., si dhe KESH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Entela Shehaj

VENDIM

Nr.37, datë 15.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DN& NAT ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a” nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DN& NAT Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “DN& NAT Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Subjekti “DN& NAT Energji” sh.p.k., ka informuar se është në proces të marrjes së lejes mjedisore dhe të miratimit të pikës së lidhjes së kërkuar nga neni 9 pika 4.1.5 i rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, duke plotësuar kërkesën e nenit 8 pika 4 të kësaj rregulloreje.

Për gjithë sa më sipër, cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “DN& NAT Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Kumbull Merkurth”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Entela Shehaj

VENDIM

Nr.38, datë 15.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “GSA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 13 pikat 1, germa “d”, dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pikat 1, germa “a” dhe 3, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregulator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b” “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “GSA” sh.p.k., për licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Entela Shehaj

VENDIM
Nr.39, datë 15.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SELISHTË”
SHPK

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Selishte” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Selishte” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte (neni 17 pika 2 germa “d”).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Selishte” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Selishte”.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.40, datë 15.4.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HP OSTROVICA ENERGY” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, nenit 5 pika 1 germa “a”, dhe neneve 13 e 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HP Ostrovica Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HP Ostrovica Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “HP Ostrovica Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Faqekuq 1” me fuqi 3 MW dhe “Faqekuq 2” me fuqi 3.4 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.41, datë 15.4.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“ENERGJI ASHTA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES HEC
“ASHTA” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “ll”, dhe nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, dhe 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, dhe nenit 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 15.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues hec “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues hec “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.42, datë 22.4.2011

**PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES DHE FATURIMIT TË
DËMIT EKONOMIK”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 pika 14 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.4.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e “CEZ shpërndarje” sh.a., për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes dhe faturimit të dëmit ekonomik”,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes të dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë shpërndarëse nga çdo ndërhyrje e paligjshme” (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ shpërndarje” sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË DËMIT EKONOMIK SHKAKTUAR KOMPANISË SË SHPËRNDARJES NGA NDËRHYRJET E PALIGJSHME

1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë së shpërndarjes nga ndërhyrjet e paligjshme.

2. Objekti

Kjo metodologji do të jetë e zbatueshme në rastet kur një entiteti të caktuar me ligj i duhet të llogarisë dëm ekonomik të shkaktuar prej ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin elektrik të kompanisë së shpërndarjes.

3. Baza ligjore për hartimin e kësaj metodologjie është ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 8, pika “d” dhe neni 51, pika “14”.

4. Përcaktimi i dëmit ekonomik

Dëmi ekonomik është vlera korresponduese në lekë e sasisë së energjisë elektrike (KWh) të konsumuar mesatarisht gjatë një viti prej një konsumatori/klienti tipik të secilës kategori.

Sasia e energjisë së konsumuar është llogaritur si produkt i konsumit mesatar mujor të një konsumatori/klienti tipik, të kategorisë ku shkaktari i dëmit bën pjesë, me numrin e muajve të një viti (12) dhe përcaktohet në tabelën e mëposhtme:

Kategoritë e klientëve	Sasia (KWh)
Kategoria e parë - klientë të vegjël Matës monofazë, elektrometër	4 000
Kategoria e dytë - klientë të mesëm Matës trefazorë, deri në 30 kW	10 000
Kategoria e tretë - klientë të mëdhenj Matës trefazorë, mbi 30 kW	20 000

Çmimet që do të aplikohen për këto sasi të llogaritura të dëmit ekonomik do të jenë çmimet e energjisë elektrike të zbatuara në periudhën jashtë pikut, të miratuara nga ERE, për kategoritë e klientëve sipas nivelit të tensionit ku ato furnizohen. Për klientët familjarë do të aplikohet çmimi i miratuar për sasinë e energjisë elektrike të konsumuar në bllokun e dytë.

5. Hyrja në fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM

Nr.43, datë 22.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDROPOWER ELEKTRIK” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet: “Sllabinje 2A”, “Sllabinje 2B”, “Sllabinje 2C” dhe “Sllabinje 2D”, “Sllabinje 2E”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Entela Shehaj

VENDIM

Nr.44, datë 22.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “OST” SHA PËR TRANFERIM ASETI PËRKATËSISHT NËN STACIONIN 110/20KV TË “KALIMASHIT” TE SHOQËRIA “CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licencës “Për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2011, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria OST sh.a. te shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “OST” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2: emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).
 - Neni 7, pika 1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij (ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja).
 - Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është plotësuar tërësisht).
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OST” sh.a., për transferim aset, përkatësisht nënstationin 110/20 kV të “Kalimashit”, të shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Entela Shehaj

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr.741, datë 25.3.2011, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar, shtetasit Adem Rovi, i biri i Enverit dhe i Valentinës, i datëlindjes 3.1.1958 dhe caktimin e kërkueses, shtetases Besime Bregu, si kujdestare.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 13.5.2011
Doli nga shtypi më 15.5.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 38 lekë